



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN

Nr. 79/2017 “PËR SPORTIN”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji që propozohet nga ministria përgjegjëse për sportin ka si qëllim rritjen e efektivitetit të zbatueshmërisë së ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar, mbështetjen e reformave të ndërmarra në fushën e sportit, zgjerimin e formës së organizimit të organizatave sportive; sigurimin, integrimin dhe gjithëpërfshirjen e veprimtarive sportive olimpike speciale për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuar fizike dhe intelektuale në Republikën e Shqipërisë etj.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave, të akteve ligjore në fushën e sportit dhe mundëson ushtrimin efektiv të funksioneve rregullatore, mbikëqyrëse dhe vlerësuese të shtetit.

Projektligji është hartuar në përputhje të plotë me angazhimin e Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, si një veprimtari

publike, që ka interesin maksimal për nxitjen dhe promovimin e tij, me qëllim përmirësimin e shëndetit dhe jetës së gjithkujt.

Projektligji është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për t'u miratuar në vitin 2024, në zbatim të vendimit nr. 790, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024".

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj ka si përparësi dhe efekte të pritshme:

- Të paraqesë risi në sistemin sportiv kombëtar duke zgjeruar formën e organizimit të organizatave sportive në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për organizatat jofitimprurëse. Fondacioni ka si objektiv kryesor të zhvillojë dhe të promovojë sportin në veçanti dhe atë për të gjithë me gjithë elementet teknike, funksionale dhe organizative me qëllim realizimin e misionit të veprimtarisë sportive, i cili është shumë i gjerë dhe përfshin dimensionin social, imazhin kombëtar, ekonomik, edukativ e shëndetësor. Për këto arsye theksohet se sporti është veprimtari me interes publik dhe pjesë e rëndësishme e politikave shtetërore në këto fusha.
- Projektligji do të mundësojë rregullimin ligjor të "Instruktur i përgatitjes fizike" dhe përfshirjen e tij në ligjin për sportin si një domosdoshmëri në sistemin sportiv kombëtar, i cili deri tani ka qenë i papërcaktuar qartë në ligjin aktual duke sjellë vështirësi në praktikë për identifikimin e saktë të instruktorit të përgatitjes fizike dhe rolit të tij.
- Përcaktimin e Komitetit Paralimpik Kombëtar Shqiptar si i vetmi organizëm për personat me aftësi fizike të kufizuar në Republikën e Shqipërisë që do të drejtojë këtë lëvizje në arenën kombëtare dhe atë evropiane, botërore dhe olimpike duke plotësuar standarde ndërkombëtare në këtë fushë.

Ky ndryshim do të “disiplinojë” procesin e anëtarësimit në këtë Komitet të federatave sportive të cilat kanë sportistë me aftësi fizike të kufizuar dhe përfaqësimi i tyre do të jetë nën logon e këtij Komiteti.

Përcaktimi i Olimpikut Special Shqiptar si një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpike speciale për personat me aftësi intelektuale të kufizuara në Shqipëri.”

- Projektligji propozon përfshirjen jashtë procesit mësimor të shoqatave sportive shkollore dhe universitare në aktivitete sportive të cilat mund të jenë dhe të shumë sporteve duke rritur përfshirjen edhe të disiplinave të tjera sportive, të cilat nuk janë pjesë e kurrikulës shkollore. Gjithashtu një risi në këtë nen është përfshirja në veprimtaritë sportive në sistemin parauniversitar dhe atë të arsimit të lartë të institucioneve shtetërore, si dhe të KOKSH për zhvillimin e projekteve të sportit shkollor dhe universitar. Përmes ndryshimit të nenit përkatës në ligjin në fuqi synohet përcaktimi më i detajuar i detyrave të dy federatave të Sportit shkollor dhe universitar mbi organizimin dhe përfaqësimin e tyre në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Një përparësi e projektligjit është synimi i një financimi të qëndrueshëm të organizatave sportive në Republikën e Shqipërisë.

Nëpërmjet parashikimeve të bëra është synuar vendosja e prioriteteve në ndarjen e fondit grand, si forma kryesore e financimit të sportit nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet kategorizimit në dy grupe të organizatave sportive: në përfitueset e drejtpërdrejta, që janë federatat olimpike, KOKSH, Organizata Antidoping, Komiteti Paralimpik Shqiptar, si dhe Këshilli i Arbitrazhit Sportiv dhe në përfitueset nëpërmjet projekteve, që janë Federatat sportive jo-olimpike, KOKSH dhe fondacioni sportiv.

Forma e financimit si dhe transferimi i fondeve buxhetore në banka të nivelit të dytë është një risi në organizimin e sportit në Republikën e Shqipërisë pasi përbën një revolucion në sistemin e financimit në sportin shqiptar.

Ky fakt do të rrisë krijimin e mundësive për vetëmenaxhim të organizatave sportive kombëtare, rritjen dhe forcimin e demokracisë së brendshme të

organizatave sportive, ndërgjegjësimin dhe disiplinimin në përdorimin e fondeve që ato përfitojnë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat dytësore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në zbatim të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk ka si qëllim përafrimin me Acquis Communautaire.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Projektligji përbëhet nga 8 (tetë) nene dhe konsiston në këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 3, të kreut I, bëhen shtesa dhe ndryshime në lidhje me përkufizimet, si më poshtë:

a) Pas pikës 6, shtohet pika 6/1 më këtë përmbajtje:

“6/1. “Fondacionet në fushën e sportit”, janë organizata jofitimprurëse të themeluara nga institucionet publike, persona juridik dhe fizik që administrojnë apo ushtrojnë veprimtari sportive dhe që financohen nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme.”.

Shtesa në këtë nen konsiderohet risi në sistemin sportiv kombëtar duke zgjeruar formën e organizimit të organizatave sportive në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për organizatat jofitimprurëse. Fondacioni ka si objektiv kryesor të zhvillojë dhe të promovojë sportin në veçanti dhe atë për të gjithë me gjithë elementet teknike, funksionale dhe organizative me qëllim përmbushjen e misionit të veprimtarisë sportive, e cila është shumë e gjerë dhe përfshin dimensionin social, imazhit kombëtar, ekonomik, edukativ e shëndetësor.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar”

b) Pas pikës 7/1 shtohet pika 7/1/1 me këtë përmbajtje:

“7/1/1. “Instruktor i përgatitjes fizike” është individ i që zotëron diplomë të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, në përputhje me llojin, profilin dhe specialitetin përkatës sportiv dhe që ofron veprimtari dhe programe të aktivitetit lëvizor dhe sportiv.”

Përkufizimi në lidhje me “Instruktor i përgatitjes fizike” dhe përfshirja e tij në ligjin për sportin konsiderohet e domosdoshme në sistemin sportiv kombëtar, i cili deri tani ka qenë i papërcaktuar qartë në ligjin aktual duke sjellë vështirësi në praktikë për identifikimin e saktë të instruktorit të përgatitjes fizike dhe rolin e tij. Rritja e kërkesës së tregut të punës, përfshirja e tyre në të gjitha disiplinat sportive do të ndihmojë në rritjen e profesionistëve në fushën e sportit elitare dhe atë për të gjithë.

Gjithashtu përfshirja e instruktorëve në palestra private, të cilat kanë një rritje të dukshme kohët e fundit, sjell domosdoshmërinë që punësimi i tyre të jetë i kategorisë së lartë pasi me mbështetjen e tyre realizohet formimi dhe ecuria e përgatitjes së sportistit elitare, e sportit për të gjithë dhe e individëve të cilët merren me aktivitete fizike. Përcaktimi i instruktorit të përgatitjes fizike vlerësohet se është një vlerë e shtuar edukative dhe shëndetësore në shoqërinë tonë.

c) Pika 12 ndryshon si më poshtë:

“12. “Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen paralimpike në Shqipëri.”

Kjo pikë ndryshon për efekt të përcaktimit të Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar si i vetmi organizëm për personat me aftësi fizike të kufizuara në Republikën e Shqipërisë që do të drejtojë këtë lëvizje në arenën kombëtare dhe atë evropiane, botërore dhe olimpike duke plotësuar standarde ndërkombëtare në këtë fushë.

Ky ndryshim do të “disiplinojë” procesin e anëtarësimit në këtë Komitet të federatave sportive të cilat kanë sportistë me aftësi fizike të kufizuara dhe përfaqësimi i tyre do të jetë nën logon e këtij Komiteti.

ç) Pas pikës 13, shtohet pika 13/1 me këtë përmbajtje:

“13/1 “Lëvizja Paralimpike” është organizim universal dhe i përhershëm për individët me aftësi fizike të kufizuara dhe subjekteve, që janë frymëzuar

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar”

nga vlerat e olimpizmit në të pestë kontinentet dhe që kryhet nën autoritetin e Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar”.

Shtesa në këtë pikë përcakton misionin dhe qëllimin e pralimpizmit në sistemin sportiv botëror dhe europian.

d) Pika 16 ndryshon si më poshtë:

“16. “Organizatë sportive” është Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, Federatat Sportive, Olimpiku Special Shqiptar, Klubet Sportive, Shoqëritë Sportive dhe Shoqatat Sportive, të cilat zhvillojnë veprimtari sportive.”.

Shtesa në këtë pikë, përcakton përfshirjen e dy organizmave të ngritur sipas përcaktimeve ligjore për organizatat jo fitimprurëse dhe ligjit për sportin të Komiteti Paralimpik Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar në sistemin e organizatave sportive në Republikën e Shqipërisë.

dh) Pas pikës 17 shtohet pika 17/1 me këtë përmbajtje:

“17/1. “Olimpiku Special Shqiptar” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpike speciale për personat me aftësi intelektuale të kufizuara në Shqipëri.”

Shtesa në këtë pikë ka për qëllim sigurimin, integrimin dhe gjithëpërfshirjen e veprimtarive sportive olimpike speciale për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara intelektuale në Republikën e Shqipërisë. Kjo organizatë akreditohet nga Olimpiku Special Botëror.

2. Në nenin 2 të projektligjit parashikohet si më poshtë:

Në nenin 6, të kreut I, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 4 e nenit 6, të kreut I, ndryshon si më poshtë:

“4. Përveç disiplinës mësimore të përfshirë si pjesë e kurrikulës, aktivitetet sportive në institucionet arsimore parauniversitare dhe në institucionet e arsimit të lartë jashtë procesit mësimor organizohen nga shoqatat sportive shkollore dhe shoqatat sportive universitare, të cilat mund të jenë të një sporti ose të shumë sporteve”;

b) Pas pikës 4 të nenit 6, të kreut I, shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Aktivitete sportive në institucionet arsimore parauniversitare dhe në institucionet e arsimit të lartë, mund të organizohen edhe nga institucionet shtetërore dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar me projekte për zhvillimin e sportit shkollor dhe universitar.”.

c) Pika 6 e nenit 6, të kreut I, ndryshon si më poshtë:

“6. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor dhe Federata Shqiptare e Sportit Universitar, krahas detyrave statutore, kanë edhe këto detyra:

a) Federata Shqiptare e Sportit Shkollor:

i) organizimin e kampionatit të shkollave në të gjitha disiplinat sportive dhe shpalljen e kampionit kombëtar të shkollave;

ii) organizimin e ekipeve përfaqësuese në veprimtaritë ndërkombëtare të sportit shkollor.

b) Federata Shqiptare e Sportit Universitar:

i) organizimin e kampionateve dhe universiadave në të gjitha disiplinat sportive dhe të shpallë kampionin kombëtar të universiteteve;

ii) organizimin e ekipeve përfaqësuese në aktivitetet ndërkombëtare të sportit universitar.”.

Ndryshimet/shtesat në këtë nen përcaktojnë përfshirjen jashtë procesit mësimor të shoqatave sportive shkollore dhe universitare në aktivitete sportive të cilat mund të jenë dhe të shumë sporteve duke rritur përfshirjen edhe të disiplinave të tjera sportive, të cilat nuk janë pjesë e kurrikulës shkollore.

Gjithashtu një risi në këtë nen është përfshirja në veprimtaritë sportive në sistemin parauniversitar dhe atë të arsimit të lartë të institucioneve shtetërore, si dhe të KOKSH për zhvillimin e projekteve të sportit shkollor dhe universitar.

Gjithashtu përcaktimi më i detajuar i detyrave të dy federatave të Sportit shkollor dhe universitar mbi organizimin dhe përfaqësimin e tyre në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Neni 3 i projektligjit synon:

a) Pas shkronjës “d”, të nenit 11, të kreut III, shtohen shkronjat “dh” dhe “e”, me këtë përmbajtje:

“dh) *Olimpiku Special Shqiptar*

e) *Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar.*”.

Shtesa në këtë pikë përcakton përfshirjen e dy organizmave të ngritura sipas përcaktimeve ligjore për organizatat jo fitimprurëse dhe ligjit për sportin të Komitetit Paralimpik Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar në sistemin e organizatave sportive në Republikën e Shqipërisë.

4. Neni 4 i projektligjit parashikon ndryshime në nenin 13 të ligjit në fuqi, si më poshtë:

Pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 13, të kreut III, ndryshojnë si më poshtë:

“1. Federatat sportive, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, Olimpiku Special Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping, Fondacioni Sportiv me themelues ministrinë përgjegjëse për sportin, financohen me fonde të dhëna nga buxheti i shtetit në formë transfertë, të parashikuara në buxhetin e shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

2. Financimi i federatave sportive olimpike, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping dhe Këshilli i Arbitrazhit Sportiv, transferohen në llogari të bankave të nivelit të dytë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për sportin dhe ministrit përgjegjës për financat.

3. Ministria përgjegjëse për sportin financon federatat joolimpike, Olimpiku Special Shqiptar, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Fondacioni Sportiv me themelues ministrinë përgjegjës për sportin me projekte nga buxheti i saj në formë transferte në banka të nivelit të dytë për veprimtari të propozuara prej tyre.”

Ky nen ndryshon së pari, për të parashikuar financimin e qëndrueshëm të organizatave sportive në Republikën e Shqipërisë.

Së dyti, nëpërmjet parashikimeve të bëra në këtë nen është synuar vendosja e prioriteteve në ndarjen e fondit grand, si forma kryesore e financimit të sportit nga Buxheti i shtetit, nëpërmjet kategorizimit në dy grupe të organizatave sportive: në përfitueset e drejtpërdrejta, që janë federatat olimpike, KOKSH, Organizata Antidoping, Komiteti Paralimpik Shqiptar, si dhe Këshilli i Arbitrazhit Sportiv dhe në përfitueset nëpërmjet projekteve, që janë Federatat sportive jo-olimpike, KOKSH, fondacioni sportiv.

Forma e financimit si dhe transferimi i fondeve buxhetore (GRANDI) në banka të nivelit të dytë është një risi në organizimin e sportit në Republikën e Shqipërisë pasi përbën një revolucion në sistemin e financimit në sportin shqiptar.

Ky fakt do të rrisë krijimin e mundësive për vetëmenaxhim të organizatave sportive kombëtare, rritjen dhe forcimin e demokracisë së brendshme të organizatave sportive, ndërgjegjësimin dhe disiplinimin në përdorimin e fondeve që ato përfitojnë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat dytësore.

5. Në nenin 5 të projektligjit synohet të bëhen shtesa të nenit 14 të ligjit në fuqi, për realizimin e rregullimit ligjor të Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar, konkretisht si më poshtë:

Pas nenit 14 të kreut III, shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar

“1. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar janë persona juridik, që organizohen dhe funksionojnë në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me Kartën Olimpikë dhe statutin e tij të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin , përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente.

2. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Paralimpikë Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj. KPKSH në ushtrimin e veprimtarisë së tij mbështetet në parimet e sistemit ndërkombëtar të sporteve paralimpikë dhe rezolutat dhe udhëzimet e nxjerra nga Komiteti Paralimpik Ndërkombëtar.

3. *Olimpik Special Shqiptar është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Special Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me marrëveshjen e licencës së akreditimit të Olimpikut Special Botëror "Special Olympics" (SOI).*

4. *Statuti dhe ndryshimet statutores të Komitetit Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpikut Special Shqiptar miratohen nga ministri përgjegjës për sportin brenda 60 ditëve nga data e depozitimit. Pas kalimit të këtij afati, Statuti dhe ndryshimet statutores konsiderohen të miratuara në heshtje. Pas përfundimit të kësaj procedure, Statuti dhe ndryshimet statutores regjistrohen në gjykatë.*

5. *Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpik Special Shqiptar mund të financohen me fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit në formë transferte, si dhe burime të tjera të ligjshme.*

6. *Ministria përgjegjëse për sportin njih vetëm një Komitet Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe vetëm një Olimpik Special Shqiptar, dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e tyre.*

7. *Në Komitetin Paralimpik Kombëtar Shqiptar aderojnë federatat shqiptare që në statut kanë të përfshirë paralimpik dhe shoqata me veprimtari paralimpik të një sporti të caktuar, organizata të tjera sportive paralimpik dhe persona juridikë me paralimpik të përfshirë, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në statutin e këtij Komiteti."*

8. *Në Olimpik Special Shqiptar mund të aderojnë federatat shqiptare ku kanë të përfshirë olimpikun special dhe personat me aftësi të kufizuara, organizata të tjera sportive dhe persona juridikë dhe fizikë, të cilët plotësojnë dhe pranojnë kushtet e përcaktuara në statutin e tij."*

Shtesa me anë të këtij neni përcakton formën, mënyrën e organizimit, ushtrimin e veprimtarisë në respekt të ligjit si dhe akteve nënligjore në fuqi, duke përcaktuar rregullat e partneritetit të shtetit me organizatat jofitimprurëse. Gjithashtu specifikohet e drejta që i jep ministria përgjegjëse për sportin për këto organizata dhe mënyra e financimit të tyre.

Komiteti Paralimpik Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar do të jenë një vlerë e shtuar e organizimit të sportit në Shqipëri duke përafruar rritjen e standardeve që kërkon sot sistemi botëror ku përveç Elitës Sportive, sportit për të gjithë i shtohet dhe gjithëpërfshirja, integriteti i personave me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale, si një nga kriteret e përafrimit të legjislacionit me BE.

6. Neni 6 i projektligjit synon si më poshtë:

Në nenin 42 të kreut VIII bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1, të nenit 42, shtohen pika 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1 Lojërat olimpike speciale dhe veprimtaritë me karakter olimpik special organizohen nga Olimpiku Special Shqiptar .

“1/2 Lojërat Paralimpike dhe veprimtaritë me karakter Paralimpik organizohen nga Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar.

2. Në pikën 3 të nenit 42 pas fjalëve “Për organizimin e lojërave olimpike....” shtohen fjalët “...dhe olimpike speciale dhe paralimpike...”.

Në këtë nen përcaktohen qartë organizmat që kanë të drejtën e organizimit të veprimtarive sportive.

7. Në nenin 7 të projektligjit parashikohet se pas nenit 58, shtohet neni 58/1, i cili përcakton rregullime ligjore mbi financimin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, Komitetit Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpikut Special Shqiptar, me këtë përmbajtje:

“Neni 58/1

Financimi i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, Komitetit Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpikut Special Shqiptar

“1. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv realizon ushtrimin e plotë të funksioneve dhe të kompetencave, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit fillon pas datës 01.01.2027.

2. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar realizon ushtrimin e plotë të funksioneve dhe të kompetencave, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit fillon pas datës 01.01.2027.

3. Olimpiku Special Shqiptar realizon ushtrimin e plotë të funksioneve dhe të kompetencave, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit fillon pas datës 01.01.2025.”.

8. Në nenin 8 parashikohet hyrja në fuqi e projektligjit.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar”

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET E TJERA QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E LIGJIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet ministria përgjegjëse për sportin.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Për hartimin e këtij projektligji kontribuoi grupi i punës i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me urdhrin nr. 416, datë 26.07.2023 "Për ngritjen e grupit të punës për draftimin e ndryshimeve në aktet ligjore dhe në fushën e sportit", në bashkëpunim me strukturat e tjera të MAS.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji ka efekte financiare për buxhetin e MAS, ku për Këshillin e Arbitrazhit Sportiv dhe Komitetin Paralimpik Kombëtar Shqiptar financimi nga buxheti i shtetit fillon pas datës 01.01.2027, i cili do të përcaktohet në ligjin buxhetor përkatës, ndërsa për Olimpikun Special Shqiptar, financimi nga buxheti i shtetit fillon pas datës 01.01.2025.

Efektet e pritshme për financimin e KAS përlllogariten në masën rreth 3.000.000 (tremiljon) leke, kryesisht për shpenzime operative ndërsa infrastruktura e nevojshme do të vihet në dispozicion të KAS në mjediset e dedikuara për federatat sportive (parku olimpike) i ndërtuar me financimin e buxhetit të shtetit.

Efektet e pritshme për komitetin paralimpik kombëtar shqiptar dhe olimpikun special do të përlllogariten në varësi me projektet që ato do të paraqesin çdo vit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe fondit në dispozicion për projekte të federatave joolimpike.

Financimi i tyre do të përballohet nga fondet grand/transfertë e pakushtëzuar e cila u shpërndahet federatave sportive dhe strukturave të parashikuara në ligjin "Për sportin" në përputhje me udhëzimin e përbashkët të ministrit të financave dhe ministrit përgjegjës për sportin.

Sqarojme se struktura e këshillit të arbitrazhit sportiv (KAS) është strukturë ekzistuese në ligjin për sportin ndërsa komiteti paralimpik kombëtar dhe olimpiku special janë struktura të reja, të cilat do të financohen me fonde nga buxheti i

MAS si dhe burime të tjera të ligjshme. Financimi i tyre do të përballohet nga fondet e buxhetit të planifikuara në PBA 2025-2027 apo në periudhat në vijim, brenda tavaneve të programit të Sportit.

PROPOZUESI

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

OGERTA MANASTIRLIU